

Sue Ryder Care



Albania

KUJDESI PALIATIV



*Kujdesi që
lehtëson jetën!*



FONDACIONI
SHOQËRIA
E HAPUR
PËR SHQIPËRINË

Financuar nga

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (Soros)

Kujdesi paliativ

Kujdesi Paliativ është një shërbim mjekësor dhe psikosocial që ka për qëllim që të përmirësojë cilësinë e jetës së pacientëve dhe familjarëve që përballen me sëmundje kërcënuese për jetën, nëpërmjet parandalimit, vlerësimit dhe trajtimit të dhimbjes dhe problemeve të tjera fizike, psiko-sociale dhe shpirtërore.

- Synon të përmirësojë cilësinë e jetës duke influencuar pozitivisht ecurinë e sëmundjes.
- Mundëson trajtimin e dhimbjes dhe simptomave të tjera të lidhura me të.
- Integron aspektet psikologjike, sociale dhe shpirtërore të përkujdesjes ndaj pacientit.
- Ofron një sistem mbështetje për t'i ndihmuar familjarët të përballojnë periudhën e sëmundjes së pacientit.
- Konfirmon jetën dhe konsideron vdekjen si një proces normal njerëzor.
- Aplikohet si tek të rriturit, ashtu edhe tek fëmijët.

Shoqata Ryder Albania

Është një organizatë jofitimprurëse, me një eksperiencë 20 vjeçare, që ofron shërbimin e

kujdesit paliativ në shtëpi të të moshuarve me sëmundje kronike dhe pacientëve onkologjik, sëmundja e të cilëve nuk i përgjigjet trajtimeve kurative. Shërbimi ofrohet nëpërmjet dy ekipeve në Tiranë, që nga viti 1993 dhe në Durrës prej vitit 1996.

Aktiviteti kryesor i organizatës është shërbimi shëndetësor në shtëpi të pacientëve, i cili ofrohet nga një grup specialistësh të disiplinave të ndryshme si mjekë, infermierë, punonjës socialë dhe psikologë. Anëtarët e ekipeve janë profesionistë të trajnuar dhe me ekspertizë në fushën e kujdesit paliativ.

Nga fillimi i aktivitetit, ekipet shëndetësore i kanë ofruar shërbim dhe kujdes paliativ rreth 6000 pacientëve terminalë, duke lehtësuar dhe trajtuar dhimbjen si dhe problemet psikologjike, sociale dhe shpirtërore.

Ndër të tjera shoqata Ryder Albania është angazhuar dhe ka kontribuar në integrimin e kujdesit paliativ në sistemin e kujdesit shëndetësor publik si në përgatitjen e hartimit të planit të veprimit, standardeve të shërbimit, manualeve të trajnimit dhe teksteve në gjuhën shqipe për profesionistë, studentë dhe të tjerë të interesuar. Së fundmi në bashkëpunim me profesionistët e fushës, është bërë i mundur integrimi i kujdesit paliativ pranë Fakultetit të Mjekësisë dhe atij të Infermierisë.

Në çfarë kriteresh bazohet shërbimi

Përfituesit e shërbimit (patientët dhe familjarët e tyre) kryesisht duhet të ndodhen në njërën nga gjendjet e mëposhtme:

- Të paturit e një sëmundje onkologjike të pakurueshme dhe në fazë të avancuar.
- I/e moshuar me sëmundje kronike në fazë të avancuar.
- Situatë e pafavorshme sociale dhe ekonomike e pacientit dhe familjarëve.

Çfarë mund të ofrojmë

- Terapi efçente dhe këshilla për kontrollin e dhimbjes dhe simptomave të tjera.
- Medikamentet, të cilat përshkruhen nëpërmjet recetave plotësisht, apo pjesërisht të rimbursueshme nga mjekët e shoqatës të kontraktuar nga ISKSH.
- Pajisje mjekësore si shiringa elektrike, dyshekë kundra plagëve që krijohen si rezultat i qëndrimit të gjatë në shtrat, karroca invalidësh, urinarë dhe oturak, aparat klizme,

aspiratorë portativ, bombola oksigjeni etj.

- Mbështetje emocionale për pacientët dhe një mundësi për të diskutuar mbi shqetësimet, apo pyetje të ndryshme rreth sëmundjes dhe trajtimit të saj.
- Mbështetje për familjarët, apo personat që kujdesen për pacientin .
- Informacion dhe këshillim për të gjitha aspektet e kujdesit dhe trajtimit.

Si punojmë

- Hapi i parë për ofrimin e kujdesit është vlerësimi i kërkesës dhe gjendjes së pacientit .
- Hapja e kartelës dhe plotësimi i saj me dokumentat përkatëse .
- Vendosja e terapisë për kontrollin e dhimbjes dhe simptomave të tjera.
- Vlerësimi i gjendjes psikosociale të pacientit dhe familjes dhe në varësi të situatës hartohet një plan ndërhyrje, ose rasti adresohet tek specialistët përkatës.
- Biseda të përditshme me familjarin, apo personin që kujdeset nga kryeinfermierja e organizatës, ose ekipi përkujdesës (mjeku, infermieri që e ndjek)
- Vizita periodike në shtëpi, të cilat mund të variojnë nga 2 – 4 herë në javë, në varësi të gjendjes së pacientit

Dokumentacioni i nevojshëm

- Raport mjekësor nga mjeku kurues me diagnozë të saktë (epikrizë), ku rekomandohet nevoja për kujdes paliativ.
- Libreza shëndetësore e pacientit.
- Kopje e pasaportës, ose kartës së identitetit, ose çertifikatë personale të sëmurit.
- Rekomandimi nga mjeku i familjes.

Të gjitha këto dokumente paraqiten tek krye-infermierja e shoqatës dhe janë të rëndësishme për të hapur kartelën e pacientit.

Disa të drejta dhe detyrime të familjarëve të pacientëve gjatë ofrimit të shërbimit

Familjarët luajnë një rol të rëndësishëm, janë partnerë kryesorë dhe pikë referimi për ekipin e ndihmës gjatë përkujdesjes ndaj pacientit. Ata kanë nevojë për ndihmë dhe mbështetje për të vlerësuar dhe

përballuar situatën e sëmundjes brenda familjes.

- Familjarët duhet të informohen në mënyrë të detajuar për sëmundjen, ecurinë e saj dhe shërbimin që iu ofrohet
- Nëse kanë paqartësi, apo vërejtje duhet t'ju drejtohen ekipit të ndihmës, apo drejtuesit të tij.
- Të refuzojë ofrimin e shërbimit, nëse e gjykojnë të panevojshëm.
- Familjarët duhet të lexojnë dhe të nënshkruajnë, nëse e quajnë të drejtë, marrëveshjen dypalëshe për mënyrën dhe rregullat e shërbimit.
- Të zbatojnë me rigorozitet rregullat e vendosura në marrëveshjen dypalëshe të shërbimit.
- Të bashkëpunojnë me ekipin e asistencës.
- Të komunikojë hapur dhe me sinqeritet për çdo problem që i shqetëson në lidhje me shërbimin.
- Të njoftojë shoqatën nëse pacienti largohet nga jeta.
- Të zbatojnë me rigorozitet terapinë e vendosur nga ekipi mjekësor dhe të njoftojë nëse ka probleme.

Kontributi juaj mbështet pacientët tanë

Ju mund të ofroni ndihmën tuaj pranë zyrave të Shoqatës Ryder Albania në Tiranë dhe Durrës (në adresën e mëposhtme) ose në numrat tanë të llogarisë në:

Banka Intesa SanPaolo
Shoqata Ryder Albania

Lek 1040731801

IBAN AL30208110080000001040731801

Euro 30463931801

IBAN AL72208111010000030463931801

USD 30463931803

IBAN AL18208111010000030463931803

Ku dhe si mund të na kontaktoni

Tiranë

Rr Ali Pashë Gucia Nd. 9, H.7, Ap.2

(pranë gjimnazit 'Partizani')

Tel/fax: +355 4 2452309

E mail: ryderalb@icc-al.org

Durrës

Lagja Nr.5, Rr. Aleksandër Goga, P.505

(pranë poliklinikës nr. 2/ish Befotrofi)

Tel/fax: +355 52 230609

Sue Ryder Care
Albania

